



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Beledijesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



01- Nr 03-2025
Me datë 28.02.2025

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 14, 17 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008) Ligji nr. 06/l-092 Për Dhënien në Shfrytëzim Dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës neni 6 paragrafi 1 pika 1.2 neni 21 paragrafi 1 dhe 2 lidhur me nenin 5 paragrafi 1 pika 1.3, nenit 13 lidhur me nenin 24 dhe 26 paragrafi 1 Rregullore (QRK) nr. 09/2020 Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5 dhe 18 STATUTI I KOMUNËS MAMUSHË, DHJETOR 2008, në mbledhjen e mbajtur me datën 28.02.2025, Kuvendi Komunal mori këtë:

V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronë së paluajtshme të Komunës

Neni 1

Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës dhe merret vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Mamushës në shfrytëzim të personave Fizik dhe Juridik në shfrytëzim afatgjatë nga 15(pesëmbëdhjetë) deri në 99 (nëndhjetë e nëntë) vite.

Neni 2

Prona e paluajtshme për dhënien në shfrytëzim, të cekur në nenin 1 të këtij vendimi, është në Zonën Kadastrale Mamushë me kulturë klasë jo pjellore e evidentuar sipas Certifikatës së Pronësisë Nr. P-73213054-01468-1 në emër të P.sh Komuna e Mamushës në vendin e quajtur Petrovica me sipërfaqe të përgjithshme 226.05 m2 i jepet në shfrytëzim K.R.U Gjakova me seli në Gjakovë.

Neni 3

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në nenin 1 të këtij vendimi, është ndërtimi i një stacioni të pompimit në kuadër të projektit Gyp i furnizimit me ujë të pijshëm dhe rrjeti i ujësjellësit.

Neni 4

Afati kohor për dhënien e pronës Komunale në shfrytëzim të cekur në Nenin 1 dhe 2 të këtij vendimi është afatgjatë në periudhën prej 99 vitesh dhe i ipet në shfrytëzim pa kompensim.

Neni 5

Obligohet- K.R.U Gjakova me seli në Gjakovë që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të filloj punët ndërtimore pas pajisjes me leje ndërtimi.

Neni 6

Prona e paluajtshme në fjalë nuk nderon titullarin juridik, pronarë i saj mbetet kuvendi Komunal i Mamushës dhe si e tillë ajo nuk mund ti jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit,

shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

Neni 7

Obligohet- Kryetari i Komunës së Mamushës që pas pranimi të këtij vendimi të përcaktoj me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe shfrytëzuesit të pronës Komunale respektivisht K.R.U Gjakova me seli në Gjakovë.

Neni 8

Pas zbatimit të këtij vendimi do kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria Urbanizimit Planifikimit Hapësinor dhe Kadastër.

Neni 9

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale dhe Rregullore (QRK) nr.06/2021 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) nr. 10/2019 Për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në wep-faqen e zyrtare të Komunës.

Të njoftohen :
Zyra e Kryetarit
MAPL
DUPHK
Arkivi

Kryesues i Kuvendit Komunal në Mamushë

Necmedin Morina

